



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.780/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllgjani kryesuese dhe Adnan Konushevcu dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Mamushës, Mehmet Mazrek nga Subjekti Politik Partia Demokratike Turke (KDTP), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Mamushës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.780/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Mamushës, Mehmet Mazrek nga Subjekti Politik Partia Demokratike Turke (KDTP), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Mamushës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave me Post në Komunën e Mamushës.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.780/2021, i ushtruar nga Mehmet Mazrek Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Partia Demokratike Turke (KDTP), me të cilën pretendon se konsideroj se votat nga diaspora nuk janë numëruar në rregull, pasi që i kanë 53 vota të konfirmuara ndërsa në rezultatet përfundimtare janë 39 vota, kështu që ka mospërputhje të votave të konfirmuara dhe atyre të numëruara, pra nuk ka pasur numërim të rregullt dhe kërkoj të rinumërohen votat me postë në Komunën e Mamushës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Partia Demokratike Turke (KDTP), Mehmet Mazrek, kërkon rinumërimin votave me Post në Komunën e Mamushë, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga

Mehmet Mazrek kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Partia Demokratike Turke (KDTP), më të cilin apel kërkon që rinumërohen votat me post.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, i njëjti nuk ka ofruar saktë vendvotimet në të cilat pretendon se nuk i kanë dalë votat, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se ka mungesë të votave, nga votat e votuesve jashtë Kosovës edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, Paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, duke mos precizuar asnjë vendvotim dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat..

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.780/2021 më datën 05.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gillogjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.